



KOMUNIKATË PËR SHTYPIN

28 mars 2017

KSC2-17

Gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave

Më 27 mars 2017, Kryetarja e Dhomave të Specializuara i referoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Rregulloren e Procedurës dhe të Provave. Ky [referim](#) vjen pas miratimit të Rregullores së Procedurës dhe të Provave në seancën e parë plenare të [gjykatësve](#) të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Duke qenë se në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar përcaktohet se Kodi i Procedurës Penale i Kosovës nuk është i zbatueshëm në Dhomat e Specializuara, paraprkisht duhej të miratohej Rregullorja e Procedurës dhe e Provave që rregullon kryerjen e procedurave gjyqësore në të gjitha nivelet e Dhomave të Specializuara: në Dhomën e Gjykatës Themelore, Dhomën e Gjykatës së Apelit, Dhomën e Gjykatës Supreme si edhe funksionet e Gjykatësit Paraprak. Gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese miratuan rregulloren e tyre procedurale që do të përfshihet në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave i kushton rëndësi mbrojtjes së dëshmitarëve, viktimave dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dhënies së dëshmisë, ose bashkëpunimit të tyre me Dhomat e Specializuara. Në tërësi, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave synon të fuqizojë paanësinë, drejtësinë, shpejtësinë, efikasitetin, ndershmërinë dhe sigurinë e procedurave të Dhomave të Specializuara, duke respektuar njëkohësisht Kushtetutën dhe standardet më të larta të të drejtave të njeriut.

Me këtë rast, Kryetare Trendafilova deklaroi: “Me miratimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave në më pak se dy muaj pas emërimit të tyre, gjykatësit treguan dijeni dhe profesionalizëm të shkëlqyer dhe një përkushtim absolut për një procedurë solide, efikase dhe të drejtë e të paanshme në Dhomat e Specializuara. Falënderoj të gjithë gjykatësit për përpjekjet e tyre të bashkërenduara dhe kontributin e tyre rrënjësor.”

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese do të ketë tridhjetë ditë për shqyrtimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave, për të përcaktuar nëse kjo Rregullore përputhet me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës. Rregullorja e Procedurës dhe e Provave hyn në fuqi shtatë ditë pasi Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese të ketë vendosur mbi kushtetutshmërinë. Me hyrjen në fuqi të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomat e Specializuara funksionalizohen tërësisht në aspektin gjyqësor.

Gjatë seancës plenare, gjykatësit miratuan edhe dy dokumente të tjera që kanë rëndësi për funksionimin e Dhomave të Specializuara – Kodin e Etikës Gjyqësore dhe Rregulloren për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara. [Kodi i Etikës Gjyqësore](#) rregullon standardet profesionale që zbatohen për gjykatësit dhe gjithashtu përcakton masat disiplinore në rast se kryhet sjellje kundërvajtëse. [Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara](#) rregullon caktimin e gjykatësve në trupat gjykues përkatës të Dhomave të Specializuara. Kodi i Etikës Gjyqësore dhe Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara hynë në fuqi menjëherë pas miratimit dhe mund të gjenden në faqen e Dhomave të Specializuara në Internet.

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave do të bëhet publike pasi Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese të ketë vendosur mbi kushtetutshmërinë e Rregullores.

Për informacion më të gjerë mbi Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe gjykatësit e Dhomave të Specializuara shkoni në: www.scp-ks.org.

KONTAKT:

Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun e Dhomave të Specializuara në mediaKSC@scp-ks.org, tel: +31(0)6 249 21 036